



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Drejtoria e Politikave Fiskale
ANALIZA E TË ARDHURAVE NË SHQIPËRI 1992-2012

PËRMBAJTJA

- Përmbledhje ekzekutive
- Sistemi i taksave dhe të ardhurat tatimore:tre periudha
- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
- Akcizat
- Tatim Fitimi
- Tatimi mbi të Ardhurat Personale
- Kontributet e Sigurimeve Shoqërore

Struktura e Raportit

Në pjesën e parë, jepet një vështrim i përgjithshëm i ecurisë së sistemit tatimor, ndryshimet thelbësore dhe të ardhurat e mbledhura; në aspektin "historik" periudha 20- vjeçare që merret në analizë është ndarë në 3 pjesë: periudha nga 1992 deri në 1997, më pas nga viti 1998 deri në 2008 dhe periudha e tretë e impaktit të krizës financiare globale, nga viti 2009 deri në vitin 2012.

Në pjesën e dytë jepet një përshkrim më i detajuar i strukturës së secilës taksë/tatim dhe ndryshimet e pësuarra përgjatë 20-vjeçarit nga secila.

***Përmbledhje ekzekutive**

Historiku 20-vjeçar i politikës tatimore të vendeve që iu nënshtruan transformimit të sistemeve politike dhe ekonomike tregon një ndarje pak a shumë të qartë të eksperiencave në dy grupe kryesore:

Vendet që reformuan njëkohësisht sistemin e taksave dhe strukturën institucionale (kryesisht vendet e Europës Qendrore dhe Lindore) për administrimin e tyre morën rezultate të mira dhe të qëndrueshme për sa i përket nivelit të të ardhurave.

Sot në Shqipëri politika e taksave zhvillohet në një kontekst institucional të përmirësuar, dhe struktura tatimore i përgjigjet mirë nevojave për mbledhjen e të ardhurave publike dhe krijimit të një klime nxitëse për zhvillimin e sektorit privat. Këtë e tregon në shifra ecuria e nivelit të të ardhurave në vite dhe ngushtimi i diferencës me vendet e rajonit.

Për nga struktura dhe të ardhurat e mbledhura, TVSH është taksa që paraqitet më mirë në sistemin tatimor shqiptar. Struktura e saj është me tre shkallë tatimore, 20, 10 dhe 0% (edhe pse tarifa e reduktuar ka aplikim shumë të kufizuar).

Të ardhurat e mbledhura në raport me PBB arritën nivelin më të lartë në 2008 me 9.8%, ndërsa në 2012 ky raport ishte 9.2%. Rimbursimi megjithëse ka pasur rritje në vlerë absolute, mbetet ende problematik, me një nivel ende të lartë TVSH të parimbursuar dhe me kohë e procedura të gjata rimbursimi.

Struktura e akcizës është përafëruar mjaft me legjislacionin e harmonizuar të Bashkimit Europian, veçanërisht me ligjin e ri të Akcizave të hyrë në fuqi vitin e kaluar. Të ardhurat kanë pasur përgjithësisht trend vjetor rritës, me përjashtim të vitit 2012, vit në të cilin të ardhurat nga akciza ishin në bazë vjetore 10 për qind më të ulëta.

Struktura e tatimit fitimit në Shqipëri është e ngjashme me atë që shumica e vendeve e kanë tatimi mbi të ardhurat e korporatave (Corporate Income Tax). Ndryshimi thelbësor me praktikën ndërkombëtare është se të qenit apo jo subjekt i tatimit fitimit në Shqipëri varet nga xhiroja vjetore e biznesit dhe jo nga forma juridike e organizimit të aktivitetit të biznesit. Norma prej 10%, në fuqi që nga 1 Janari 2008, është nga më të ulëtat e rajonit dhe më e ulët se të gjitha vendet e Evropës Perëndimore. Politika e ndjekur reflekton orientimin në të gjitha vendet CEE dhe ato të rajonit, drejt uljes së barrës tatimore për bizneset dhe

thjeshtimin e skemave taksuese nga elemente të përjashtimit apo lehtësirave fiskale për sektorë dhe biznese të veçantë.

Në harkun kohor 20-vjeçar ecuria e të ardhurave të mbledhura nga tatim-fitimi ka qenë e ndryshueshme.

Tatimi mbi të ardhurat personale ka qenë një nga taksat më të goditura nga evazioni fiskal në Shqipëri.

Reforma fiskale e vitit 2007 ndryshoi në thelb strukturën e kësaj takse, duke zëvendësuar shkallët progresive të taksimit me një shkallë unike prej 10%, për të gjitha llojet e të ardhurave personale. Ndryshimi i fundit ligjor i TAP rriti progresivitetin e tatimit, duke përjashtuar nga taksimi pagat deri në 30 000 lekë.

Shqipëria ka nivelin më të ulët të taksimit të të ardhurave personale në rajon (ashtu si dhe Bullgaria), prej 10%.

Të gjitha vendet e rajonit dhe një pjesë e madhe e vendeve CEE aplikojnë taksën e sheshtë. Megjithëse nuk ka një opinion të konsoliduar mbi efektin e taksës së sheshtë mbi të ardhurat dhe mbi ekonominë e vendeve që e kanë adoptuar, Shqipëria, në rreth 5 vjet eksperiencë me taksën e sheshtë, ka treguar impakt pozitiv mbi të ardhurat e mbledhura.

Megjithë diferencën e vazhdueshme me vendet e tjera, raporti ndaj PBB i TAP në Shqipëri ka ndryshuar ndjeshëm, duke arritur pikën më të lartë në 2009 (2.3%).

Nga të dhënat në vite konstatohet se më shumë se gjysma e gjithë të ardhurave nga TAP mbliidhen nga tatimi mbi pagat.

Me politikat e zbatuara në mënyrë komplementare dhe të njëkohshme me vendosjen e taksës së sheshtë (vendosja e pagave referuese dhe detyrimi për kalimin e pagës nëpërmjet sistemit bankar) ky tatim u bë më i kontrollueshëm dhe administrimi dhe mbledhja u përmirësuan ndjeshëm, mbështetur kjo nga shifrat e të ardhurave menjëherë pas reformës.

Ashtu si tatimi mbi të ardhurat personale, hallkë tjetër e dobët e sistemit tatimor kanë qenë kontributet e sigurimeve shoqërore.


Megjithatë, në vitet e fundit sistemi i sigurimit shoqëror ka qenë në qendër të reformave, si përse i përket barrës së tatimit ashtu dhe pajtueshmërisë së kontribuuesve dhe administrimit të tyre.

Të ardhurat nga kontributet paraqesin diferencën më të lartë me vendet e tjera të rajonit, sesa të gjitha taksat e tjera të marra në shqyrtim.

*VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Në terma shumë të përgjithshme, totali i të ardhurave në buxhet, ka kaluar nga 33.5 miliardë lekë në vitin 1993 në 329.8 miliardë lekë në vitin 2012, me një rritje prej 10 herë. Po të bëjmë një ndarje në tre grupe: ndihmat, të ardhurat tatimore dhe jo tatimore, ndihmat rezultojnë në 2012 në të njëjtin nivel me 1993, por me ulje të ndjeshme kundrejt viteve 1998-2001; të ardhurat tatimore kanë rritje 13 herë dhe të ardhurat jo-tatimore rritje 5 herë ndaj 1993. Në raport me PBB, në vitin 1996 Shqipëria mblidhte 15.1 lekë për çdo 100 lekë produkt të brendshëm, ndërsa në 2012 ky indikator ishte në nivelin 24.5. Ecuria në vite tregohet më qartë në grafikun më poshtë.

Grafik 1. Të ardhurat 1993-2012




*Taksim direkt vs indirekt

Në terma të strukturës së taksimit, përgjatë viteve ka pasur një zhvendosje të taksimit nga taksat mbi tregtinë drejt TVSH dhe Akcizave. Aktualisht shumë pak të ardhura vijnë nga tarifat doganore që i aplikohen importeve. Nga ana tjetër, taksimi indirekt (mbi konsumin) është dominant në mbledhjen e të ardhurave kundrejt taksimit të të ardhurave (individë dhe kompani) dhe pasurisë. Grafiku në vijim pasqyron ecurinë e taksimit direkt dhe atij indirekt në vite.

Siç vihet re nga paraqitja grafike, gjatë gjithë periudhës kemi “dominim” të të ardhurave të mbledhura nga tatimet që rëndojnë konsumin, siç janë: TVSH, Akcizë dhe Taksë doganore, kundrejt tatimeve që rëndojnë direkt të ardhurat e përfuara nga individë dhe biznese dhe pasurinë e tyre (ndërtesa apo tokë bujqësore). Madje, edhe në ritmin e rritjes, të ardhurat nga taksimi indirekt pësojnë rritje më të theksuar se tatimet direkte, veçanërisht në periudhën 1998 deri në 2008, vit nga i cili ndihen pasojat e rënies së konsumit dhe si rrjedhojë të prodhimit të brendshëm dhe importit.

Në këtë raport të të ardhurave nga taksimi indirekt vs direkt kanë ndikuar disa faktorë: tatimet indirekte janë më të thjeshta për t’u mbledhur, veçanërisht ajo pjesë që mblidhet në momentin e importit, ndërsa tatimet direkte (sidomos mbi të ardhurat individuale) për kohë të gjatë kanë qenë objekt i niveleve të larta të shmangies dhe evazionit tatimor; përveç kësaj, politika e ndjekur ka qenë ajo e uljes së vazhdueshme të normave të taksimit direkt, me fokus të veçantë tatim fitimin; ndërkaq, lidhur me taksimin indirekt, norma e TVSH është mbajtur e pandryshuar që në vitin 1996 (kur hyri në fuqi tatimi mbi vlerën e shtuar) dhe akciza ka pësuar rritje të vazhdueshme për mallrat kryesore si karburante dhe cigare.


Grafik 2. Të ardhurat nga taksimi direkt dhe indirekt, në mln lekë, 1993-2012



Shënim: Për efekt analize, në grupin e tatimeve dhe taksave direkte kemi përfshirë tatimin mbi të ardhurat personale, tatimin mbi fitimin, tatimin mbi pasurinë dhe taksën e

biznesit të vogël; në taksimin indirekt kemi përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar, akcizën dhe taksën doganore.

Grafik 3. Pesha e taksimit direkt dhe indirekt në totalin e të ardhurave tatimore




Shënim: Kemi mbajtur të njëjtën llogaritje për grupimet e taksimit direkt dhe indirekt

Një efekt të rëndësishëm ka pasur në të ardhurat e mbledhura edhe ndryshimi përgjatë viteve i strukturës së PBB. Më këtë nënkuptojmë veprimin e dy faktorëve strukturore: uljen graduale të peshës së sektorit publik në ekonomi (pra shkalla e privatizimit dhe liberalizimit të ekonomisë) dhe brenda sektorit privat, uljen e kontributit të bujqësisë (që është një sektor i pataksuar) në favor të sektorëve që u bënë kontribuues të rëndësishëm të të ardhurave, si: ndërtimi, prodhimi, shërbimet. Kështu, në vitin 1996 sektori i bujqësisë përbënte 35.1 të PBB totale, ndërtimi përbënte vetëm 4.9 për qind, prodhimi 9.5 për qind; të njëjtët sektorë në vitin 2012 janë respektivisht 14.8%, 8% dhe 12%.

Tjetër faktor ndikues ka qenë administrimi, në kuptimin e efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave, masat kundër evazionit, edukimin e taksapaguesve, rritjen e bazës së taksueshme. Progres i rëndësishëm shënohet në fushën e administrimit, për tatime dhe dogana, veçanërisht duke filluar nga viti 1998 e më tej. Ndër zhvillimet më të rëndësishme mund të përmendim: strukturimin e administratës tatimore sipas funksioneve bazë; kompjuterizimin; ndarjen dhe specializimin e funksioneve të Njesisë së Tatim-paguesve të Mëdhenj; shkrirja e zyrave të vogla lokale në struktura rajonale më të mëdha dhe më të pakta në numër;

rritje e kapaciteteve të personelit dhe alokim i përshtatshëm i stafit; rritje e numrit të taksapaguesve të regjistruar përmes thjeshtimit të procesit të regjistrimit; përmirësimi i procedurave të kontrollit tatimor përmes zhvendosjes në kontrolle specifike kundrejt atyre të përgjithshme dhe rritjes së përdorimit të analizave të riskut, etj.

Grafik 4. Të ardhurat në përqindje të PBB




***PERFORMANCA E TË ARDHURAVE PËR PERIUDHËN 1993-1998**

Grafiku 5 më poshtë tregon se të ardhurat nga taksat në periudhën fillestare tranzitore, në Shqipëri ashtu si në të gjitha vendet në tranzicion kanë rënë dukshëm.

Në këtë periudhë reforma tatimore ishte e pakompletuar dhe përgjithësisht jo e shoqëruar me reformën e duhur administrative, prandaj dhe të ardhurat, veçanërisht ato tatimore, performuan jo mirë në të ardhurat në raport me PBB.

Në fillim të periudhës tranzitore, 1992-1995, performanca e të ardhurave nga taksat ishte në nivel të kënaqshëm për situatën, 20,5%, 19%, dhe 24% ndaj PBB, dhe ndryshimi nga mesatarja e vendeve në tranzicion respektivisht për vitet 1993, 1994 dhe 1995 ishte në trend rënës **-13,%, -12,% dhe -6,1%**. Në vitet 1996 dhe 1997, për shkak të pështjellimit ekonomik dhe social që pasoi lulëzimin dhe rënien e skemave financiare piramidale, të ardhurat tatimore patën rënie në raport me PBB, ndërkohë që vetë Prodhimi i Brendshëm Bruto pati një rritje nominale negative prej rreth 0.06 për qind.

Grafik 5. Të ardhurat tatimore 1993-1998, në mln lekë



Në këtë periudhë pati disa faktorë vendimtarë që influencuan performancën e të ardhurave, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vendet në tranzicion:

- Së pari, historia dhe pika e fillimit, influencuan dukshëm në procesin e reformës së taksave. Vëmë në dukje se Shqipëria e pati pikën e fillimit nga zero.
- Vendet të cilat qysh në fillimet e tranzicionit kanë performuar më mirë me të ardhurat, e kanë ruajtur këtë trend edhe në periudhat në vijim.
- Në të kundërt, vendet e tjera, të cilat kanë performuar më dobët se të parët, kanë vijuar të mbajnë diferencat me këto vende.
- Kjo për shumë faktorë, ku kryesorë janë diferencat në nivelet e taksimit, kultura e dobët e administratës tatimore dhe taksapaguesve, si dhe prirjet më të theksuara për evazion nga taksat, të nxitura edhe nga ambienti institucional dhe ligjor. Sistemi i taksave është po aq i rëndësishëm sa edhe zbatimi i tyre.
- Eksperiencia ka treguar se reformat efektive të taksave nuk mund të përmbushen të izoluara nga aftësitë e sistemit të administratës së taksave dhe kultura e taksapaguesve.
- “Gabimi” tjetër i vendimmarrjes me këtë periudhë ishte fokusimi tek *modernizimi i politikave të taksave*, duke i kaluar çështjet e administratës dhe pajtimit vullnetar të taksapaguesve në plan të dytë.

Në Shqipëri, ashtu si edhe në vende të tjera në tranzicion, u favorizuan qëndrime ndërhyrëse duke siguruar


•regjime speciale (përjashtime dhe lehtësira nga taksat, apo *tax-holidays*), të cilat në kthim, e bënin më të lehtë evazionin fiskal, deformimet, abuzimet, duke rritur kostot administrative dhe ndarjen jo të drejtë të barrës tatimore midis taksapaguesve.

•Për të qenë efektive dhe e suksesshme reforma e taksave është e nevojshme të shoqërohet me reforma institucionale dhe strukturore në të gjithë ekonominë. Ato vende në tranzicion, që kanë lëvizur më shpejt për të ristrukturuar ekonominë e tyre dhe institucionet, gjithashtu edhe fiskalisht kanë përparuar më mirë (Çeki, Estoni, Hungari, Poloni, dhe Slloveni). Në veçanti, reformat institucionale në fusha komplementare me reformën fiskale të tilla si sistemet kontabël dhe detyrimet e ligjeve të falimentit janë vërtetuar si vendimtare.

* **PERFORMANCA E TË ARDHURAVE NË PERIU DHËN 1999-2008**

Më përfundimin e periudhës së de-stabilizimit të shkaktuar nga rënia e skemave piramidale, të ardhurat tatimore në përqindje të PBB patën një trend rritës në vitet në vazhdim, me rritje më të theksuar deri në vitin 2008, kur të ardhurat tatimore ndaj PBB arritën në 24.3 për qind dhe më pas përqindja nga PBB u stabilizua. Rritja mesatare vjetore e të ardhurave deri në 2008 ka qenë në nivelin e konsiderueshëm 18 për qind. Ky nivel tejkalon në masë të konsiderueshme rritjen nominale të PBB, çka do të thotë që në të ardhurat e mbledhura ka luajtur rol të rëndësishëm faktori i administrimit fiskal. Gjithashtu i rëndësishëm është edhe indikator i të ardhura ndaj PBB. Ky indikator tregon rritje të vazhdueshme gjatë periudhës në fjalë, veçanërisht për zërin “të ardhura nga Tatime dhe Dogana”. Rritja e raportit të të ardhura/PBB reflekton zhvillimet në ekonomi, me kalimin gradual nga zona jo-monetare në zonën informale dhe nga zona informale në atë formale. Me rritjen relative të ekonomisë formale ndaj asaj jo formale rritet dhe kontributi në të ardhura për çdo njësi PBB.


Grafik 6: Të ardhurat tatimore në raport me PBB 1999-2008 (% ndaj PBB)



Në totalin e të ardhurave tatimore në këtë periudhë zhvillime të rëndësishme ka pasur për sa i takon tatimeve të veçanta.

Me shfuqizimin e tatimit mbi qarkullimin dhe zëvendësimin e tij me Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, në vitin 1996, TVSH u bë burimi kryesor dhe më i qëndrueshëm i të ardhurave në sistemin tatimor shqiptar. Sistemi i TVSH-së në legjislacionin fiskal shqiptar është hartuar në mënyrë të admirueshme: ai është i thjeshtë, me bazë të gjerë, përmban një shkallë tarifore standarde prej 20% dhe ka një prag përjashtimi të arsyeshëm, tipik për vendet në zhvillim. Rritja mesatare vjetore e të ardhurave nga TVSH ka qenë për periudhën rreth 14 për qind.

Grafik 7: Të ardhurat tatimore sipas zërave kryesore, 1999-2008 (mln lekë)



Në këtë periudhë të ardhurat nga tatim fitimi dhe të ardhurat personale u rritën në vlerë absolute dhe në % të totalit në strukturën e të ardhurave, duke reflektuar zhvillimet pozitive ekonomike, përmirësimin e klimës së investimeve dhe politikat e zhvillimit të sektorit privat.

Politika më e rëndësishme tatimore e kësaj periudhe për taksimin direkt ishte vendosja e taksës së sheshtë në vitin 2007, për taksimin individual dhe për fitimin e kompanive.

Siç e thamë dhe më lart, ndryshimi i strukturës dhe nivelit u shoqërua me masa administrative që ndikuan në rritjen e ndjeshme të të ardhurave nga ky tatim.

Në mënyrë të veçantë, taksa e sheshtë për taksimin e individëve ndikoi në thjeshtimin e administrimit të sistemit dhe rritjes së bazës së taksueshme.

Tatimi mbi të ardhurat personale ka qenë një nga taksat më të goditura nga evazioni fiskal në Shqipëri.

Reforma ndryshoi në thelb strukturën e kësaj taksë, duke zëvendësuar shkallët progresive të taksimit me një shkallë unike, për të gjitha llojet e të ardhurave personale, prej 10%.

Rritja mesatare vjetore e të ardhurave nga TAP për periudhën në fjalë ka qenë në nivelin 42 për qind.

Në kontekstin e taksimit të të ardhurave nga ushtrimi i biznesit, përgjysmimi i tatim fitimit la në dispozicion të sipërmarrësve një nivel likuiditetesh të vlerësuar në rreth 72.5 miliardë lekë (llogaritur në harkun kohor 2008-2011).

Për vitin 2008 të ardhurat nga tatim fitimi përbëjnë 2.2% të PBB nga 1.1% që ishin në vitin 1998.

Shfuqizimi gradual i përjashtimeve dhe lehtësirave nga tatim-fitimi ka thjeshtuar sistemin, e ka bërë më transparent dhe ka reduktuar hapësirat për evazion.

Politika e akordimit të lehtësirave dhe përjashtimeve është zëvendësuar me atë të uljes së vazhdueshme të taksave për biznesin.

Norma statutoe e tatim-fitimit është ulur në vite, nga 30% në 1999 (pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8438, 28.12.1998), në 20 % në 2007 dhe 10% që nga Janari i 2008.

Për sa i takon nivelit të mbledhjes, rritja mesatare vjetore për periudhën 1999-2008 ka qenë rreth 16.5 për qind.

Nga ana tjetër, të ardhurat nga tarifat doganore pësuan ulje të ndjeshme, si pasojë e politikave të liberalizimit të tregtisë të aplikuara nga Shqipëria.

Rritje të vazhdueshme kanë pasur dhe të ardhurat nga Akciza, nga niveli i ulët i vitit 1997, si rezultat i përmirësimeve në kuadrin ligjor dhe administrim.

Legjislacioni për akcizat në vendin tonë ka qenë objekt i ndryshimeve të shpeshta.

Nivelet e akcizës në Shqipëri kanë pasur rritje të vazhdueshme, ashtu si dhe gama e produkteve dhe mallrave që i nënshtrohen kësaj takse.

Për këtë periudhë Shqipëria ka pasur rritje të qëndrueshme të të ardhurave nga akciza në % të PBB. Rritja mesatare për periudhën në fjalë është 21.5 për qind.

Ashtu si tatimi mbi të ardhurat personale, hallkë tjetër e dobët e sistemit tatimor kanë qenë kontributet e sigurimeve shoqërore. Megjithatë, përgjatë viteve, sistemi i sigurimit shoqëror ka qenë në qendër të reformave, si për sa i përket barrës së tatimit ashtu dhe pajtueshmërisë së kontribuesve dhe administrimit të tyre. Në Dhjetor 2002 qeveria shqiptare vendosi transferimin dhe unifikimin e mbledhjes së kontributeve tek administrata tatimore. Ky proces zgjati disa vite. Administrimi dhe mbledhja e kontributeve lidhet ngushtë dhe me rritjen e ndërgjegjësimit të popullatës mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në skemën e sigurimit të detyrueshëm.

Duke i konsideruar kontributet në aspektin e “kostos së punës”, politika ka qenë ajo e uljes së vazhdueshme të normës kontribuuese të punëdhënësit, duke u kujdesur që kjo të mos ndikojë negativisht në të ardhurat e mbledhura, por të kundërbalancohet nga rritja e deklarimeve dhe numrit të personave në skemë. Rritja mesatare vjetore e kontributeve të mbledhura për periudhën në fjalë ka qenë rreth 11.7 për qind.

***PERFORMANCA E TË ARDHURAVE NË PERIUDHËN 2009-2012**


Viti 2009 ishte viti i parë i ndikimit të krizës globale ekonomiko-financiare në ekonominë shqiptare, edhe pse me efekt më pak të ndjeshëm së në rajon.

Ngadalësimi i ritmit të rritjes ekonomike u reflektua në aftësinë kontribuuese në taksa dhe tatime të individëve dhe bizneseve, si në aspektin e taksimit direkt (të të ardhurave) ashtu dhe në atë të taksimit indirekt përmes uljes së konsumit të mallrave dhe shërbimeve.

Përgjatë periudhës 2009-2012 rritja mesatare vjetore e të ardhurave nga tatimet dhe doganat ka qenë 3.2 për qind në baza vjetore.

Në raport me PBB të ardhurat totale arritën në 24.5 për qind, niveli më i ulët që nga viti 1998. Në grafikun që vijon paraqitet ecuria e të ardhurave sipas zërave kryesore, nga 2008 deri në 2012.

Grafik 8: Ecuria e tatimeve më të rëndësishme 2009-2012 (mln lekë)



Zërat me të rëndësishëm të tatimeve janë rritur me ritme mjaft të ngadalta përgjatë periudhës 2009-2012, ndërsa në 2012 të ardhurat nga TVSH, Akciza dhe Taksimi direkt pësuan rënie krahasuar me një vit më parë.

Për sa i takon politikave, edhe gjatë periudhës së fundit, reforma në fushën tatimore ka vijuar, dhe pritet që ndryshimet e bëra të ushtrojnë ndikimin e tyre në vitet në vijim. Përmendim këtu: reformimin e akcizës që përfshin përafrimin e legjislacionit me BE dhe kalimin e administrimit të saj tek administrata doganore; reformimin e TVSH, me draftimin e ligjit të ri në përputhje me Acquis.